Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>                     | <i>3</i>     | <i>4</i>               | <i>6</i>                                 |       |
|---|------------------------------|--------------|------------------------|--|-------|
| <b>Artikulli</b>                          | <b>Përshkrimi i mallit</b>   | <b>Sasia</b> | <b>çmimi per njësi</b> | <b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b> |       |
| 1.  |                              |              |                        |  |       |
| 2.  |                              |              |                        |  |       |
| 3.  |                              |              |                        |  |       |
| 4   |                              |              |                        |  |       |
|   | <b>Çmimi total (Mallrat)</b> |              |                        |  | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                              |              |                        |  |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                              |              |                        |  |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                              |              |                        |  |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                              |              |                        |  |       |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |                              |              |                        |  |       |
| <b>Vula</b>                               |                              |              |                        |  |       |
| <b>Datë</b> _____                         |                              |              |                        |  |       |

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:

#### **1. XHUP SINTETIK (XHAKAVENTO) - KUNDRA SHIUT**

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të xhupit sintetik të Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike ( 1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore  $170 \pm 172$  cm, prerja III), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0,3 ml gjatësi lënde e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjërësia e tekstit. Të dy anët e tekstit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

#### **Materialet që do të përdoren për prodhimin e Xhupit (xhakaventos):**

- Material sintetik, 100% poliamid, i papërshkueshem nga uji, cilesi e pare.
- Pesha e materialit poliamid =  $165 \text{ gr} / \text{m}^2$ .
- Dy shtresa gomimi e dy shtresa akriliku. - Thurje garniture.
- Poshtë astarit vendoset vatine =  $120 \pm 5 \text{ gr} / \text{m}^2$ .
- Astar mëndafshi importi ( blu i errët ose i zi ), 100 % poliester, qepur në formë rombi.
- Pesha e astarit për  $\text{m}^2 = 125 \pm 5 \text{ gr}$ .
- Numuri i fijeve si në bazë e ind ( per 10 cm ) do të jetë  $340 \pm 10$  fije .
- Qëndrueshmëria ( kg ) në bazë =  $95 \pm 5$ ; ndersa në ind =  $90 \pm 5$ .
- Viera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Një xhep në gjoksin e majtë, i brëndshëm, me kapak nga jashtë që mbërthehet me pergine, nje xhep i brendshem në anën e djathtë që mbërthehet me kopse ebaniti dhe dy xhepa përpara - poshtë me prerje diagonale.
- Mbërthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhëmbë plastike dhe 3 pergina ( me sustë).
- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliester.
- Mënget, tek dora kanë llastik, por dhe rrip që mbërthehet me pergine, po kështu mbërthehen dhe spaletat.
- Ngjyra blu e errët. Jaka me stof ngjyre e zezë. Me kapuç fëshfëshe që mblidhet prapa jakës.
- Fashë fosforeshente, ngjyrë argjendi më gjerësi 30 m/m në shpinë, gjoksin e djathtë dhe 20 m/m tek rripi i mëngëve.
- Prodhoet në përmasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .
- Gjatësia për madhësinë XL = 86 cm.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me

---

qëndisje me penj të bardhë “ POLICIA BASHKIAKE ” dhe nën të qepet Stema e Bashkisë. Fusha e harkut dhe e stemës është në ngjyrë blu të hapur dhe anash me një komizë (imitim thurje ) me qëndisje me penj të kuq.

- Në gjoksin e djathtë mbi fashë qepet bazament velkrofi për numrin personal.

## **2. XHUPI OPERACIONAL**

Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike ( 1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore 170 -f 172 cm, prerja III), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga nje pjesë 0, 3 ml gjatësi lënde e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjerësia e tekstitit. Të dy anët e tekstitit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt).

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

### **Materialet që do të pëdoren për prodhimin e Xhupit (xhakaventos):**

- Material sintetik, 100% poliamid, kundra ujit, cilesi e parë, = 165 gr / m<sup>2</sup>.
- Ngjyra blu e errët. - Thurje: Sarzh.
- Poshtë astarit vendoset vatine = 120 ± 5 gr / m<sup>2</sup>.
- Astar mëndafshi importi ( blu i errët ose i zi ), 100 % poliester, qepur në formë rombi.
- Pesha e astarit për m<sup>2</sup> = 125 ± 5 gr.
- Numuri i fijeve si në bazë e ind ( per 10 cm ) do të jetë 340 ± 10 fije .
- Qëndrueshmëria ( kg ) në bazë = 95 ±5; ndërsa në ind = 90 ± 5.
- Viera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Një xhep në gjoksin e majtë, i brëndshëm, me kapak të madh (shih skicen ) nga jashtë që mbërthehet me Zinxhir konfeksioni plastik, një xhep i brëndshëm në anën e djathtë që mbërthehet me kopse ebaniti dhe dy xhepa përpara - poshte me prerje diagonale.
- Mbërthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhëmbë plastike dhe 3 përcina (me sustë).
- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliester.
- Mëngët, tek dora kanë bishtok dhe mbërthehen me pergine, po kështu mbërthehen dhe spaletat.
- Jaka me stof ngjyrë e zeze.
- Me kapug fëshfëshe që mblidhet prapa jakes.
- Fashe fosforeshente, ngjyre argjendi me gjërësi 30 m/m ne shpine dhe në gjoksin e djathtë.
- Prodhohet në përmasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .
- Gjatësia për madhësi XL = 86 cm.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qendisje me penj të bardhë “ POLICIA BASHKIAKE ” dhe nën të qepët Stema e Bashkisë. Fusha e harkut dhe e stemës është në ngjyre blu të hapur dhe anash me një komize (imitim thurje ) me qëndisje me penjë të kuq.
- Në anën e djathtë të gjoksit mbi fashë qepet bazament velkrofi për numrin personal.

## **3. KOSTUM TERITAL BLU**

Këto specifitime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kostumeve blu të Policisë Bashkiake.

Realizohen me tekstil të tezgjahur në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrave fizike (1 xhakte, 1 kapele, 1 pale pantallona ), numër gjoksi 54; gjatësi trupore

173 - 178 cm ( prerja IV ), kapele nr.56, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0.3 ml gjatësi lënde e parë (stof blu) dhe sa gjërësia e tekstilit. Mostrat e sjella nga prodhuesi e te miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve do të shërbejnë si baze për prodhim.

#### **Materialet që do të përdoren për prodhimin e kostumeve:**

- Stof ngjyre blu i errët, cilesi e parë me përzierje 45 % lesh dhe 55% poliestër ( ±3% );
- Numri i fillit: a) Në bazë = 40/2, 42/2; b) Në ind = 40/2, 42/2;
- Dëndësia ne 10 cm: a) Në bazë = 310 ±10; b) Në ind = 260 ± 10;
- Qëndrueshmëria kg: a) Në bazë = 90-6; b) Në ind = 80-6;
- Astar mëndafshi importi (blu e errët ose e zezë) 100% poliestër.
- Merlë ( material ngjites special dhe i përshtatshëm për pjesën e gjoksit ), 100% poliestër. Frazeline (material ngjitës për xhakëtën dhe pantallonat).
- Astar xhepi, tekstil 100% viskoz. - Vata (jo pambuku) të posapme për kostum burri.
- Penj qepje blu 80/2, qepje industriale 100% poliestër. - Thurje = sarzh.
- Kopsa të vogëla e të mëdha, ngjyre argjendi. Fusha e kopsës të jetë e pastër, pa relieve e konfiguracione të ndryshme brenda.
- Kanavace importi, 100% lesh.
- Stof leshi me ngjyrë të përshtatshme për pjesën e nënteshme të jakës së xhakëtës.
- Viera e qëndrueshmërisë së ngjyrave nota 4-5.
- Peshë për m<sup>2</sup> = 290 ± 10 gr.
- **Xhaketa** : Monopet, me katër kopsa të mëdha para, me prerje hark nga shpatulla deri në fund, me garje prapa. Me dy xhepa pllake poshte (180 x 210 mm ) me kapak dhe lartë ( 140 x 160 mm ). Xhepat kanë muzhike vertikale. Mbi xhepin e djathtë qepët velkrof për numurin personal dhe në krahun e majtë, poshtë kokës së supit qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë ” POLICIA BASHKIAKE ” dhe nën të stema e Bashkisë. Spaletat me përmasa: 50 x 130 mm, me fileto të kuqe anash, mbërthehen me kopse metalike ngjyrë argjendi. Dy xhepa të brëndshëm që mbërthehen me kopse ebaniti ngjyrë e zezë.
- **Pantallonat** : Kanë dy xhepa anësor me prerje diagonale dhe një xhep prapa ( 120 x 150 m/m ), pa kapak, mbërthehet me kopse ebaniti. Kanë nga dy pensa në të dy anët. Zinxhir konfeksioni për mbërthimin e pantallonave, me dhëmbë plastik. Kapse metalike mashkull - femer për mbylljen e pantallonave dhe bishtok. Qëmer i përgatitur për pantallonat. Shtatë vega për kalimin e rripit 50 mm të gjërë.

#### **TERITALI BLU**

- Modeli-tip oficeri.
- Ka formë vezake.
- Materiali dhe ngjyra si e kostumit.
- Prodhet në dhjetë numëra ( 53 -f 62 ). Numuri përfaqëson perimetrin e kokës. Strehë plastike (të mos deformohet nga ndryshimi i temperaturës së ajrit), me shkëlqim nga sipër, me gjerësi në qendër 50 mm, në ngjyrë të zezë, me astar. Nga brenda kapelja ka astar mëndafshi, dhe rreth tepelekut ( nga brenda ) ka të qepur një shirit lekurë me gjërësi 5 cm. Për të ruajtur formën, nga brenda vendoset një fletë geliku 5 mm e gjërë me fortësi deri 60 mangan. Mbi strehë vendoset një shirit plastik i zi ( për inspektoret ngjyrë argjendi) me shkëlqim, me gjerësi 15 m/m dhe mbërthehet anash me dy kopsa të vogëla metalike në ngjyre argjendi. Në ballë vendoset sterna e Bashkisë me përmasa: 50 m/m gjatësi e 34 m/m gjërësi. Të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të standartit SSH/EN ISO 13688:2013

#### **Legjenda:**

A - lartësia e rrethit të kapelës sipas perimetrit të kokës.

**B** - gjerësia e urave përpara.

**C** - gjerësia e urave prapa ( **shënim**: urat përpara dhe prapa janë të përforcuara me fortëse të kollaritur).

**D** - gjatësia e tepelekut të kapelës.

**E** - gjerësia e tepelekut të kapelës.

**F** - përmasat e rrethit plastik në tepelek.

#### **4. PËR KOSTUM DOK-TRIKOTON**

Këto specifitime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kostumit dok-terikoton të policisë bashkiake.

Realizohen me tekstil të tezgjahur, në linjë industriale në mbështetje të pamjës së jashtme të mostrave fizike ( lxxhakëtë, lkapelë, lpalë pantallona ), numur gjoksi 54; gjatësi trupore 173 -f 178 cm ( prerja IV ), kapele nr.56, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqeruara me nga një pjesë lendë e parë 0.3 ml gjatësi dhe sa gjërësia e tekstitit.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi ( porositiësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si baze për prodhim.

#### **Materialet që do të përdoren për prodhimin e kostumeve:**

- Dok terikoton blu i errët, me fije kuadrate të vogla (antistatic) cilësi e parë, përzjerje 67% poliestër me 33% pambuk( $\pm 3\%$ );

- Pësha për  $m^2 = 260 \pm 5$  gr. - Thurje = sarzh 3/1. - Numri i fillit: Në bazë e ind = 35/1  $\pm 3$  ; Dëndësia në 10 cm :

a) Në bazë  $470 \pm 6$ ; b) Në ind  $210 \pm 6$  ;

- Qëndrueshmëria kg : a) Në bazë = 153 - 6 ; b) Në ind = 60 - 6 . - Frazeline ( fortëse). Shirit fosforëshent në ngjyrë argjendi për në shpinë të xhakëtës me gjerësi 30 m/m.. Astar xhepi tekstil, 100% viskoz dhe qemer i përgatitur për pantallonat. Ekstrafor, zinxhir konfeksioni 22 - 24 cm me dhëmbë plastik për pantallonat; Penjë qepje blu 80/2 , qepje industriale 100% poliestër . -Per^nat me tel sustë. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës të lëndës së parë të jetë nota 4 – 5 ( SSH 658 - 88 ).

**Xhaketa** me jakë sport, me spaleta, me katër xhepa pllakë me kapak në gjoks dhe poshtë gjoksit të cilët mbyllen me nga dy velkro, mbyllja përpara me zinxhirë dhe me ballome e cila të jetë jo më shumë se 6 cm e gjërë. Ajo fsheh zinxhirin dhe mbyllet me tre butona me diametër 1.5 cm. Me llastikë të gjërë në të dyja anët e belit. Mansheti i mëngës të jetë me gjërësi 4 cm dhe mbërthehet me velkrof. Mansheti të këtë një carje te lehtë në polse me thellësi 10 cm. Në krahun e majtë, poshtë kokës së supit, qepen shenjat dalluese. Mbi xhepin e djathte, në gjoks qepet velkrof për numurin personal. Të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të standartit SSH/EN ISO 13688:2013

**Pantallonat** të kenë dy xhepa para të brëndshëm; dy xhepa anësor tip zarf 18 cm dhe lartësi 20cm me kapak 6cm dhe gjërësi 18cm; dy xhepa prapa pllakë 14 cm dhe lartësi 15cm me kapak 16cm dhe lartësi 6cm me mbyllje me dy velkrofe ne skajë; Mbyllja përpara të jetë me sallki me zinxhirë dhe me qemer 4cm të gjërë i cili përshkruhet nga pesë ylyqe.

**Kapela** sportive, me strehë të gjatë plastike e veshur me dokun e vet, me përforcim në kupë, me rrip prapa për rregullimin e gjërësisë, në ballë shkruar me qëndisje me penjë të bardhë në formë harku “POLICIA BASHKIAKE” dhe poshtë qepet stema e Bashkisë.

#### **Pantallonat prodhohen në gjatësitë dhe prerjet e poshtëshënuara:**

**Gjatësia e trupit (në cm)**

155-160

161-166

**Gjat. e pantallonit (cm) Prerja**

93

97

parë

dytë

|         |     |         |
|---------|-----|---------|
| 167-172 | 100 | tretë   |
| 173-178 | 103 | katërt  |
| 179-184 | 106 | pestë   |
| 185-190 | 110 | gjashtë |

## **5. PANTALLONA TERITALI VERE**

Këto specifikime përcaktojnë kërkesat cilësore për prodhimin e pantallonave të verës të Policisë Bashkiake me tekstil të tezgjahur, ngjyrë blu i errët, cilësi e parë.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (një palë pantallona verë, numur gjoksi 54 ( 173 -178 cm, prerja e katërt), të ndertuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqeruara me një pjesë lëndë e parë me gjatësi 0.3 ml (tekstil blu i errët) dhe gjërësi sa vetë tekstili.

Mostra e sjelle nga prodhuesi dhe të miratuar nga përdoruesi ( porositësi), të depozituara sipas kërkesave do të shërbejë si bazë për prodhimin e pantallonave.

Konsiderohen difekte të përhapura të pamjes së jashtme dhe nuk lejohen papastërti me orgjinë bimore, njolla të ndryshme, nuanca të ndryshme të ngjyrës, oksidime, rrudhosje, mungesë fije në bazë e ind, trashim filli, lëkundje në gjërësi etj(S.SH. 1038-88).

Ngjyra e mostrës do ti nënshtrohet provës si ndaj( fërkimit të thatë, të njomë, në larje solucioni, sapunë, djersë, etj.) dhe nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituara. Copa e bardhë që do të shoqëroje mostrën pothuajse nuk ndotet, mbetet pa ndotur, (S.SH. 658-88).

### **Materialet që do të përdoren për prodhimin e pantallonave të verës:**

- Stof blu i errët, cilësi e parë, i tezgjahur me përzjerje 35%viskoz dhe 65% poliestër (±3%).
- Peshë për m<sup>2</sup>: 210 ±5gr.
- Thurje = sarzh 2/1.
- Frazelinë (material ngjitës).
- Numuri i fillit: në bazë = 45/2 ±3; ne ind =52/1 ±3.
- Dëndësia per 10 cm: në bazë =340 ±6 ; ne ind =265 ±6.
- Qëndrueshmëria (kg): në bazë=153 - 6; ne ind = 70-6.
- Viera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Astar xhepi dhe qëmeri, tekstil 100% viskoz.
- Penj qepje blu 80/2, 100% poliestër ; qepje industriale.
- Zinxhir plastik konfeksioni 22-<sup>^</sup>24cm, kapse metalike (femër-mashkull), bishtok për mbërthimin e pantallonave.
- Përpara ka katër pensa (dy në çdo anë) me thellësi 12 deri 15 m/m.
- Me dy xhepa anësor me prerje diagonale, një xhep prapa -djathtas me përmasa120x150 m/m, mbërthimi me kopse ebaniti të zezë me katër vrime.
- Qemer i përgatitur për pantallonat. Shtatë vega më gjerësi 50 m/m për kalimin e rripit të pantallonave.

## **6. KËMISHË ME MËNGË TË GJATA**

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave të Policisë Bashkiake, me mëngë të gjata, me pupline të tezgjahur, cilësi e parë.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrave fizike ( këmishë nr. 41/42 dhe dy jaka te gatëshme ) e prodhuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me 0.3ml gjatësi lëndë e parë (tekstil bojë qielli) dhe sa vetë gjërësia e tekstilit. Të dy anët e tekstilit të jenë të mbyllura në formë të rregullt.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e te miratuar nga përdoruesi ( porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve do të shërbejnë si bazë për prodhim .



## **Materialet që do të përdoren për prodhimin e këmishave:**

- Puplinë cilësi e parë, bojqielli, tekstil i tezgjahur, me përzierje 33% pamb.dhe 67% poliest.(± 3%).
- Fortëse mansheti për mëngët me kollaritje të plotë.
- Prodhoen me jakë të mbyllur.
- Numuri i fillit: në bazë 75/1 -80/1; ne ind 75/1-80/1.
- Numurat e gjoksit 7, nga 44 - 56 .
- Dëndësia në 10 cm: ne baze  $450 \pm 10$  ; në ind  $300 \pm 10$ .
- Pesha : =  $108 \pm 3$  gr.
- Thurje garniture.
- Qëndrueshmëria (kg): 70 -6 ; ne ind 40 - 6.
- Penjë qepje 100 % poliestër me ngjyrën e tekstilit ose ngjyrë tjetër mendryshim të pa përfilshem.
- Numurat e jakës:36,37-38,39-40,41-42,43-44,45-46,47-48,49-50.
- Frazeline me ngjitje për forcimin e spalines, kapakeve të xhepave.
- Në gjoks ka dy xhepa pllakë me muzhik, me kapak më përmasa 14x16 cm.
- Kopsa të vogëla me ngjyrën e tekstilit ose të bardha të shndritshme me katër vrima. Kopsa të vogëla plastike ngjyë argjendi për xhepat dhe spalinat.
- Në krahun e majtë, poshtë kokës së supit qepet shiriti hark me fushë bojeqielli, ku shkruhet me qëndisje me penjë të bardhë “POLICIA BASHKIAKE” dhe nën të qepet sterna e bashkisë.
- Në gjoksin e djathtë, mbi qepjen e kapakut të xhepit, qepet bazament velkrofi 70x20 m/m për vendosjen e numurit personal.
- Viera e qëndrueshmërisë së ngjyres të lëndës së parë (pupline boje qielli)të jenë të qëndrueshme e shumë të qëndrueshme, nota 4-5 sipas S.SH.- 658/ 13- 88 .
- Konsiderohen difekte të perhapura të pamjes së jashtëme dhe nuk lejohen: papasterti me orgjinë bimore, njolla të ndryshme, spërkatje me vajra ose bojra,nuanca të ngjyrës, oksidime, palosje, rrudhosje, mungesë fije në bazë e ind, trashim i fijeve, lëkundje në gjerësi etj..
- Mostrat e puplines që shoqërojnë këmishet të jenë me gjatësi 600- 700m/m (S.SH.658-88).

## **7. KËMISHË ME MËNGË TË SHKURTRA**

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave me mëngë të shkurtër për Policinë Bashkiake, me pupline të tezgjahur, cilësi e parë, me përzierje 33% pambuk dhe 67% poliestër(± 3%).

Realizohen në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostres(një këmishë me nr jake 41/42), të ndërtuar më materialet e poshtëshenuara, të shoqëruar me një jakë dhe një pjesë 0.3 ml gjatësi lëndë të parë pëlhure sintetike më gjërësinë e vet tekstilit.

Mostra e sjellë nga prodhuesi e të miratuar nga përdoruesi (porositesi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si baze për prodhim.

## **Materialet që do të përdoren për prodhim:**

- Puplina është në ngjyrë dhe me cilësi të njëjta me puplinen e këmishave me mëngë të gjatë, penjte për qepje etj..
- Jaka e mbyllur me kollaritje .
- Spalinave dhe kapakëve të xhepave u vendoset frazelinë.
- Gjatësia e mëngës për prerjen e parë është 250 m/m, me rritje nga 10(dhjetë) m/m për

---

çdo prerje, gjërësia 230 m/m.

- Qepja të bëhet me penjë 100% poliester në ngjyrën e këmishes me 25-30 shpime gjilperë në 50 m/m gjatesi.
- Mëngët në fund kthehen nga brënda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Mëngët në fund kthehen nga brënda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Dy xhepa pllakë në gjoks, me përmasa: gjërësi x lartësi= 140x160 m/m, me kapak(shih skicat).
- Kapaket e xhepave dhe spalinat mbërthehen me kopsa në ngjyrë argjendi.
- Kapaket e xhepave, spalinat dhe mëngët (në bashkim me trupin) të kenë tegela nga jashte me 3 -  
4 hapa ne 10 (dhjetë) m/m dhe me largësi nga buza 5 mm.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës sësupit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje, me penjë tëbardhë “POLICIA BASHKIAKE” shiriti në formë harku me gjatësi: harku i sipërm 105 m/m, harku i poshtëm 80 m/m, gjërësia 25 m/m dhe fileto e kuqe në të gjithë gjatësinë e buzëve. Ky shirit qepet 15 m/m poshtë kokës së supit, simetrik me qepjen e spalines. Poshte shiritit 33 m/m qepet Stema e Bashkisë, simetrike me harkun e poshtëm.

## **8. KËPUCË (1/2) ME LËKURË NATYRALE BOKS VII**

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këpucëve gjysma. Realizohen në linje industrial në mbeshetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike një palë këpucë nr. 41- 42, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me një pjesë 30 x 20 cm lëndë e parë, boks viçi + astar meshin viçi cilësi e parë.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe të miratuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

### **Materialet që do të përdoren për prodhimin e këpucëve :**

- Lëkurë me faqe natyrale, boks vipi ngjyrë e zezë. Lëkuret të jenë të shtrira mirë, të buta, të mbushura, të ngjeshura e kompakte.
- Astar meshin viçi, pa sharruar, me trashësi 0.9 + 1.2 mm për astar shtroje dhe pjesën e brëndëshme e përparme(astar faqe). Mëshina me prekje me dorë të jetë e bute, e ngjeshur, e kompakte, e shtrirë, lejohet të ketë pak push. Mëshina të ketë ngjyrë të njellojtë në të gjithë sipërfaqen dhe të qëndrueshme. Në astar faqja e brëndëshme e përparme etj.(pa astar shtroje) lejohet që mëshina të jetë me trashësi 0.7 + 0.9 mm.
- Taban soleti (lëkurë natyrale), me trashësi 2 + 3 mm. Tabanit në pjesën e thembrës i vendoset një kamarete (shirit peliku) të kanalizuar me vrature të përmasave: gjatësia 80+85 mm gjërësia 8+10 mm dhe trashësi 1+1.2 mm.
- Penj sintetik mbi 9 kg, nr. 40/3 dhe 30/3 për qepjen e veshëve, prapshtina, filetat dhe tegelat etj.
- Gjerësia e pjesës së mbyllur të faqes së makines dy gjylperesh të ketë distance 1.5+2 mm.
- Tegeli duhet të jetë 1+1.5 mm largë buzëve dhe të ketë 3-4 hapa në 10 mm në lapetë dhe në rumbullaksinë e theksuar ku uniformiteti nuk ruhet. Në mbylljen e syprines, bëhet përforcimi me tegela dopio.
- Bombë termoplastike në pjesën e majës të këpucës.

- Fortë termoplastike ose kartoni të presuar, i posaçëm që nuk thyhet, i lyster me solucion kundra ujit ( që nuk thith ujë ).
- Shollë gomë të presuar, nga poshtë me lule e kanale, me thellësi  $4\pm 5$  mm. Taka e këpucës bashkë me kanalet e poshtëme të jetë me lartësi 22-f23 mm, ndërsa bashkë me fjapen do të jetë me lartësi 28-L30 mm. Taka të jetë unike, një trup me shollën e gomës.
- Ngjitës me një komponent për ngjitjen e fjapes me tabanin dhe me dy komponentë për ngjitjen e fjapes me shollën e gomës. Rezistenca e ngjitjes së fjapes me tabanin dhe e fjapes me shollën të jetë shume e mië.
- Me katër vrima në të dy anët, me syza, për kalimin e lidhësave .
- Lidhësat të jenë të zeza, të rrumbullakta, prej fije teritali e poliestre deri 600 mm gjatësi.
- Maja e këpucës të jetë kare (gjysëm katrori), në formë harku të lehtë në të dy këndet.
- Lartësia e qafës së këpucës (duke ju referuar nr. 41) e matur nga jashtë mbi xhiron e gomës të jetë  $65 \pm 1$  mm, ndërsa e matur nga brënda mbi astarin shtrojë të jetë  $58+1$  mm.
- Në pjesën e sipërme prapa qafës së këpucës, vendoset sfungjer më gjerësi 15 mm dhe gjatësi  $250 + 275$  mm në varësi të numurit.

#### **KARAKTERISTIKAT FIZIKO-MEKANIKE E LËKUREVE NATYRALE (Boks vici) PËR KËPUCË GJYSMA (1/2), (S.SH-1143-89)**

- Trashësia : 1.1-1.4mm
- Yndyra në % : 4-7
- Rëzistenca ndaj këputjes së faqes : 2.0
- Qëndrueshmëria e plasjes së faqes 10 Mp ( $\text{kg}/\text{mm}^2$ ) : 1.8
- Qëndrueshmëria deri në këputje në % : 40-60
- Penetrimi i ujit në jo më pak se : 40' (dyzete minuta)

#### **SHOLLE GOME E FJAPE GOMË TË PRESUAR**

- Fortësia në gradë shore :  $75 \pm 3$

#### **9. SPECIFIKIME TEKNIKE PËR KËPUCË ME QAFA, TRUPË, ME LËKURË NATYRALE**

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këpucëve me qafa, trupe për Policinë Bashkiake.

Realizohen në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashteme të mostrës fizike, një palë këpucë nr. 41-42, të ndërtuara me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar me një pjesë lënde e parë  $30 \times 20$  cm, vaqet cilësi e parë + astar meshin dhije cilësi e parë.

Mostrat e sjella nga prodhuesi dhe të miratuara nga përdoruesi ( porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si baze për prodhim.

#### **Materialet që do të përdoren për prodhim :**

- Faqe natyrale ( vaqete) cilësi e parë, kromato, tip “ U ”.
- Astar meshin dhije 0,9-rl,lm/m për të gjitha pjesët e brëndeshme. Lejohet me trashësi 0,740,9 m/m në faqet e brëndeshme e të përparme .
- Taban soleti (lëkurë natyrale ).
- Kamarete qeliku e mbuluar me kartonfibër të prësuar.

- Penj sintetik mbi 9 kg. nr. 40/3 - 30/3 për qepjen e syprines. - Mbyllja e syprinës me tegela dopio ose 4 copë butona për palë.
- Bombe termoplastike për pjesen e majës.
- Fortesë termoplastike ose karton i presuar i posagem për prapshinën.
- Fjape gomë të presuar me trashësi 2, 8 ~3.0 mm.
- Xhiro gome të presuar, trashësia 2, 8 43.0 mm.
- Shollë gomë të presuar ( nga poshtë me llokma të dhëmbëzuara ). Trashësia pa llokma: 7-8 mm, me llokma: 17 -f 18 mm.
- Taka e këpucës me llokmen, lartësia 25 -f 26 mm, ndërsa bashkë me hapsirën që shoqërohet me xhiron e gomës, lartësinë e takës do të jetë  $32 \pm 1$  m/m.
- Penj sintetik fill 1 m/m me rezistencë 38 kg për qepjen e fjapes me tabanin.
- Ngjitës më nje komponent për ngjitjen e fjapes me tabanin.
- Ngjitës me dy komponent për ngjitjen e fjapes me gomen (shollen).
- Me katër vrima me size në fillim në të dy anët e ne vazhdim të vrimave gjashtë kapse në formë gonxhe ose fisash për kalimin e lidhsave në forme kordoni.
- Lartësia e qafës së këpucës  $230 \pm 2$  m/m mbi xhiron e gomës.
- Nëmbyllje të lartësisë midis kapsës 8 dhe 9 deri tek kapsja e 10 (sa gjerësia e tyre ) nga 20 m/m larg buzëve (vizë ose gonxhe ) vendoset sfungjer midis astarit dhe lëkurës dhe e qepur brënda jashtë me penje sintetik.
- Semenca makinë më gjatësi 8-r9 m/m për mbërthim të faqes së këpucës me tabanin në pjesën e prapme .

## **KARAKTERISTIKAT FIZIKO-MEKANIKE E LËKURËVE NATYRALE (bojs-viçi) PËR KËPUCE ME QAFË (SSH-2638-87) (SSH 2896-87)**

- Trashësia : 1.9 - 2.5mm
- Yndyra në % : 8-11
- Rezistenca ndaj këputjes së faqës : 2.0
- Qëndrueshmëria e plasjes së faqes 10 Mpa (kg/mm<sup>2</sup>) : 1.6
- Qëndrueshmëria deri në këputje ne % : -70
- Penetrimi i ujit në jo më pak se : 240' (4 ore)

### **SHOLLË GOME E FJAPE GOME TË PRESUAR**

- Fortësia në gradë shore : **Sholla** :  $85 \pm 3$   
**Fjapa** :  $75 \pm 3$

### **10. KRAVATA**

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kravatave. Realizohen në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtëme të mostrave fizike ( një kravatë ) të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruar më një pjesë 0.3 ml gjatësi lëndë të pare pëlhure sintetike dhe sa gjëresia e tekstilit. Mostra e sjellë nga prodhuesi e te miratuar nga përdoruesi (porositësi), të depozituar

---

sipas përcaktimeve, do të shërbeje si bazë për prodhim.

### **Materialet që do të përdoren:**

- Materiali cilësi e parë, pëlhurë sintëitike, 100 % poliëstër.
- Ngjyra blu e errët.
- Gjatësia  $500 \pm 20$  mm ;
- Gjërësia  $45 \pm 5$  m/m në fillim (koka) e  $80 \pm 5$  m/m në fund.
- Me astar mëndafshi, importi, (blu i errët ose i zi), 100% poliester. Frazelinë për fortëse nga brënda, e lidhur në formë kokë dhe në fund të jëtë në formë trekëndëshi dybrinjëshëm.
- Me llastik të gjerë 15 m/m që kalon dhe fiksohet brenda kokës, dhe në të dy anët e llastikut qepët velkrof për t'u mbërthyer në qafë me gjatësi 40 deri 50 m/m.
- Pësha e pëlhurës sintëitike  $190 \pm 5$  gr/m<sup>2</sup>.

### **11. SPALETA (E HEQSHME NË FORMË KËLLËFI)**

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të spaletave të heqëshme për Policinë Bashkiake, të realizuara në linjë industriale, në mbështetje të mostrës fizike, një palë spaleta.

### **Materialet që do të përdoren :**

- Dok i cilesisë së parë, i plastifikuar;
- Pësha :  $120 \pm 5$  gr / m<sup>2</sup>;
- Ngjyra blu e errët;
- Përmasat: gjatësia në mes=95m/m; gjërësia në të dy daljet është përkatësisht: 50m/m dhe 58m/m.
- Gjithë konturet e spaletës janë me një fileto plastike të kuqe me gjerësi 3 m / m.

### **12. PULOVRA**

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të pulovrës së Policisë Bashkiake.

Realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashteme të mostrës fizike ( një pulover nr. gjoksi 54/4, gjatësi trupore 173-178 ), të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara.

Mostra e sjelle nga prodhuesi e të vlerësuar nga përdoruesi ( porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbeje si bazë për prodhim.

### **Materialet që do të përdoren për prodhimin e pulovrës :**

- Fill, cilësi e parë, me përzjerje 50 % akrilik + 50% lesh .
- Pësha =  $600 \pm 10$  gr.
- Ngjyre blu e errët.- Punim i thjeshtë.- Numuri i fillit 40/2 - 42/2.
- Dok terikoton blu me përzjerje pambuk e poliëstër për përforcimet e supeve e të brylave.
- Frazeline (fortëse) për përforcimin e spaletës. - Në gjoksin e djathtë vendoset velkrof për bazamentin e numurit personal me përmasat 75 x 20 m/m..
- Vlerat e qëndrueshmërisë së ngjyrave të lëndës së parë (fill blu), të jenë të qëndrueshme e shumë të qëndrueshme (nota 4 - 5 ). Ngjyra e mostres që do t'i nëneshtrohet provës në qëndrueshmëri të ndryshme (si ndaj fërkimit të thatë, të

njomë,në larje solucioni,sapun e djersë,etj.) nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituar. Copa e bardhë që do të shoqërojë mostrën në provë nuk duhet të ndotet, (S.SH.-658 - 88 ).

- Jaka në formë v-je, llastiku me gjerësi 30 m/m. - Mbyllja e mëngëve dhe e fundit të trupit me llastik me gjerësi 50 m/m.
- Në krahun e majtë, 15m / m poshtë kokës së supit qepet shiriti në formë harku ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë "POLICIA BASHKIAKE" dhe poshtë tij sterna e bashkisë e vendosur mbi një katërkëndesh doku vertikal që ka një xhep.
- Spaletat, dok i plastifikuar me gjerësi 45 m/m dhe gjatësi sipas numurave, që mbërthehen me kopsa të vogela plastike, në ngjyrë argjendi.
- Në lëndën e parë ( fill blu ) cilesia e parë që do të përdoret për prodhimin e pulovrave të Policisë Bashkiake, konsiderohen difekte të pamjes së jashteme dhe nuk lejohen : papasterti me orgjine bimore, njolla të ndryshme, sperkatje me vajra ose bojra, nuanca te ngjyres, oksidime, rrudhosje, mungesë fije në bazë e ind apo trashim i tyre, luhatje në gjerësi etj, S.SH.1038 - 88).

Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti SSH/EN duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016.

#### **TABELA E MASAVE**

( PËRMASAT E SHPREHURA NË CM – TOLERANCË +/- 3%)

|  | <b>XS</b> | <b>S</b> | <b>M</b> | <b>L</b> | <b>XL</b> | <b>XXL</b> | <b>XXXL</b> | <b>4XL</b> |
|--|-----------|----------|----------|----------|-----------|------------|-------------|------------|
| 1/2 e Perimetrit të kraharorit (e matur nën sqetull) .                 | 57        | 61       | 65       | 69       | 73        | 76         | 80          | 84         |
| Gjatësia e përgjithshme e pelerinës (nga supi deri në linjën fundore). | 97        | 104      | 115      | 122      | 127       | 132        | 137         | 142        |
| Gjatësi mënge ( e matur nga pjesa e sipërme ).                         | 73        | 76       | 79       | 82       | 85        | 86         | 86          | 86         |

*Shënim: numri rendor përputhet me numrin në preventiv. Shoqëria fituese përpara prodhimit duhet të konsultohet me Autoritetin Kontraktor mbi përmasat dhe kërkesave të tjera.*

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

| Nr. | Përshkrimi   | Njësia  | Sasia |
|-----|--|---------|-------|
| 1   | Xhup sintetik  | copë    | 300   |
| 2   | Xhup operacional (xhakavendo)                                      | copë    | 300   |
| 3   | Kostum terital (1 xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 copë kapele)       | komplet | 400   |
| 4   | Kostum doku trikoton (1 xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 copë kapele) | komplet | 400   |
| 5   | Pantallona teritali vere   | copë    | 600   |
| 6   | Këmishë mëngë të gjata   | copë    | 600   |
| 7   | Këmishë mëngë të shkurtra  | copë    | 600   |
| 8   | Këpucë gjysma, lëkurë  | palë    | 606   |
| 9   | Këpucë lëkurë, me qafa, trupe                                      | palë    | 500   |
| 10  | Kravatë, pëlhurë sintetike   | copë    | 500   |
| 11  | Spaleta ( dok i plastifikuar)                                      | palë    | 600   |
| 12  | Pulovër leshi +akrelik   | copë    | 500   |

**Afatet e lëvrimit:** Artikujt duhet të dorëzohen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune nga lidhja e kontratës.

| Artikulli | Përshkrimi   | Shuma | Destinacioni                         | Periudha e dorëzimit  |
|-----------|--|-------|--------------------------------------|-----------------------|
| 1         | Xhup sintetik  | 300   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 2         | Xhup operacional (xhakavendo)                                      | 300   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 3         | Kostum terital (1 xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 copë kapele)       | 400   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 4         | Kostum doku trikoton (1 xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 copë kapele) | 400   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 5         | Pantallona teritali vere   | 600   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 6         | Këmishë mëngë të gjata   | 600   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 7         | Këmishë mëngë të shkurtra  | 600   | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |

---

|    |                               |     |                                      |                       |
|----|-------------------------------|-----|--------------------------------------|-----------------------|
| 8  | Këpucë gjysma, lëkurë         | 606 | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 9  | Këpucë lëkurë, me qafa, trupe | 500 | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 10 | Kravatë, pëlhurë sintetike    | 500 | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 11 | Spaleta ( dok i plastifikuar) | 600 | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |
| 12 | Pulovër leshi +akrelik        | 500 | Policia Bashkiake,<br>Bashkia Tiranë | Brenda 60 ditëve pune |



---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

##### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

##### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë

---

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, *nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **2.3.2 Oferta teknike:**

1. Skeda teknike të tekstilit të përdorur për prodhimin e artikujve, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

2. Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

3. Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti SSH/EN për veshjet/pajisjet mbrojtëse duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016. Për këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesi Certifikatën përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk 4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike mostrat/ kampionet e artikujve që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST në përputhje me specifikimet teknike, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik detyrimisht duhet të paraqesin nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.
- b) Mostrat fizike të ndërtuara me lëndë të parë tekstil të jenë të shoqëruara me nga një pjesë 0,3- 0,5 ml gjatësi lëndë të parë (tekstil sipas objekteve të uniformës) dhe sa gjerësia e vetë tekstilit në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit. Të dyja anët e tekstilit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt) dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre.
- c) Mostrat fizike si këpucet etj të ndërtuar me lëndë të parë lëkure të jenë shoqëruar nga një pjesë 0,3X0,3cm lëkure në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre.
- d) Të gjitha detajet e mostrave (produkt të gatshëm) që do të paraqiten nga operatorët ekonomike të jenë të qepura me penj të kuq me tegela të definuar si duhet pa fije të dala.
- e) Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave (*psh:Nr.1- Xhup sintetik, referuar preventivit “Shtojca 2”/ shtojcës 6*).

